

VENDIM
Nr.275, datë 6.4.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.956, DATË 24.11.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË SHKODRËS TË
PRONËS NR.373 “ISH- GRUP ARTILERIE ”, NË TEPE, SHKODËR, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.956, datë 24.11.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:
- Në titullin e vendimit dhe në pikat 1 e 2 të tij, fjalët “...Ish-grup artilerie...” të zëvendësohen me fjalët “... Reparti ushtarak nr.1150...”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha